

Fitor OLLOMANI
E FOLJMA E LUMËS PASURI E GEGËRISHTES VERILIRNDORE

Abstrakti: Nëndialektet dhe të folmet krahinore janë pasuri e vyer e një gjuhe, kulture dhe të një populli. Tiparet gjuhësore të tyre janë bartëse të historisë, kulturës dhe mendësisë së një populli që nga ngjizja deri në ditët e sotme. Studimi i të folmeve krahinore është një kontribut në evidentimin e pasurisë gjuhësore që mbartin, konservatorizimit, të komunikimit e tyre mes njëri – tjetrit dhe me gjuhën standarde si dhe mendësinë krahinore të pasqyruar në sistemin frazeologjik. Në punimin tonë do të përpiqemi të përshkruajmë tiparet gjuhësore të të folmes së Lumës si pjesë e gegërishtes verilindore, parë në këndvështrimin e shprehjes së pasurisë gjuhësore, parë në aspektet e mëposhtme: Vështrim gjeo – historik dhe kulturor për krahinën e Lumës; e foljma e Lumës në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipës; tiparet fonetike të të folmes së Lumës si bartëse të konservatorizimit të shqipës; tiparet morfologjike dhe sintaksore të të folmes së Lumës tregues i zhvillimit historik të shqipës; pasuria leksikore dhe frazeologjike të të folmes së Lumës si shprehje e mënyrës së jetesës në hapësirën gjeografike të Lumës.

Punim është realizuar përmes një pune hulumtuese në terren, analizës, interpretimit të materialit gjuhësor si dhe të studimeve pararendëse mbi këtë të folme.

Fjalët kyçe: Dialekt, nëndialekt, të folmet krahinore, e folmja e Lumës, tipare gjuhësore, pasuri leksikore dhe frazeologjike.

Hryje

Dialektet janë një pasuri gjithëkombëtare, po aq pasuri janë edhe të folmet krahinore. Studimi i të folmeve krahinore sjell një kontribut në kodifikimin e tipareve të rralla gjuhësore, me qëllim ruajtjen e tyre në formën natyrale në të cilën shfaqen si një pasuri e çmueshme. Krahinë e Lumës bën pjesë në Gegërinë Verilindore si nga pozicioni gjeografik ashtu edhe për nga tiparet gjuhësore që mbart. Në fushën e dialektologjisë, e folmja e Lumës ka qenë objekt studimi për shumë autorë, qasja jonë studimore konsiston në evidentimin e pasurisë gjuhësore sot dhe në etapat zhvillimore të saj. Një këndvështrim tjetër ka të bëjë me analizën e materialit gjuhësor me qëllim njohjen e mendësisë së folësve të kësaj krahinë, kjo përmes sistemit leksiko – semantik duke u fokusuar më së shumti në sistemin frazeologjik. Për të krijuar një panoramë më të qartë për lexuesin, në fillim të punimit tonë kemi parashtruar një vështrim gjeo – historik dhe kulturor për krahinën e Lumës. Në këtë pjesë të punimit lexuesi do të njihet me shtrirjen gjeografike, çështjet e kulturës materiale etj.

Vështrim i gjeo – historik dhe kulturor për krahinën e Lumës

Luma e mirëfilltë (Rrafshaj) është një ultësirë me lartësi 450 m mbi nivelin e detit, që shtrihet gjatë rrjedhës së dy Drinave. Nga lindja e kësaj ultësire ngrihen malet e Pikllimës, Gjalicës, Tejës e Kolesjanit, kurse nga perëndimi dhe veriperëndimi rrethohet nga Drini i Zi dhe Drini i Bardh.

Gjatësia e Lumës, nga veriu (Përroi i Poslishtit) në jug (Qafa e Kolesjanit), në vijë të drejtë, është rreth 20 km, ndërsa ajo lindje – perëndim jo më shumë se 3 – 4 km.

Rrafsha e Lumës ndahet pothuaj përgjysmë nga lumi Lumë, në të djathtë të tij janë 10 fshatra që formojnë zonën e Tërthores, ndërsa në të majtë gjenden 28 fshatra që formojnë rrafshën.

Që në lashtësi, lumjanët kanë krijuar traditat e tyre të mbarshtrimit të dheneve, më pas do të shquhen si blegtorë të mirë. Jo më pak ka mbetur e zhvilluar edhe bujqësia për faktin se toka e Rrafshës së Lumës ka qenë shumë pjellore (pozicionimi në dy anët e lumit Luma dhe pranë Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë).

Vendbanimet e Lumës kanë qenë të vendosura pranë burimesh lumenjsh, me shtëpi të veçanta, apo të grumbulluara sipas barqeve dhe vëllazërive. Ndërtesat mbizotëruese, në këta dy –tri shekujt e fundit, kanë qenë shtëpitë njëkatëshe, më e rrallë ajo e tipit kullë. Në zonat pranë pyjeve të lisit gjenden edhe shtëpitë me trungje (me mure druri). Stanet e lumjanëve kanë qenë në formë katërkëndëshi kënddrejtë e këto dalloheshin prej tipit katror të sllavëve dhe atij rrethor të vllahëve (Hoxha, 1999: 29). Luma ka një pozicionim gjeografik shumë të rëndësishëm. Ajo ndodhet në një nyje, udhëkryq, ku takohen rrugët që vijnë nga Shkodra, Mirdita, Dukagjini, Dibra dhe dilnin në Kosovë. Qendra e hershme e Lumës ka qenë Prizreni. Lumjanët dallohen nga malësorët përreth edhe nga veshja e tyre tradicionale. Veshja e burrave është e njejtë për tërë krahinën. Veshja me tirq e me koporane kishte shmangur veshjen me fustanellë, që ishte e pranishme në një kohë më të hershme, në kohën kur Han-i ishte në këtë zonë për studimin e tij dialektologjik, në gjysmën e dytë të shek. XIX. Mbështjellësja e bërë me pala ka qenë karakteristike për veshjen e grave deri në mesin e shek. XX. Veglat muzikore karakteristike të zonës së Lumës janë: *fyelli*, *bishnica* (*lloj zumaraje*), *çiftelia*, *curlja e lodra*. Lirika popullore e kësaj zone është mjaft e pasur me motive të ndryshme, e përafërt me lirikën mirditore dhe të Opojës. Vihet re një mospërngjasim me lirikën e Hasit dhe Gjakovës. Koreografia e kësaj zone është shumë e pasur, sidomos ajo e burrave që ka një karakteristikë të veçantë, ku shquhet për mënyrën e rëndë e burrërore të ekzekutimit të valleve me origjinë të hershme ilire (molose). Sako, Z, (1972) *Rreth gjenezës së valles pyrike*, Studime Filologjike, Nr.4, f. 95 – 98.

Edhe varianti kanunor i Rrafshës së Lumës është disi i ndryshëm nga krahinat përreth (Dokle, 1999:35).

E folmja e Lumës në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes

Gjuha shqipe ka dy dialekte, dialektin e toskërishtes dhe dialektin e gegërishtes. Dialekti gegë shtrihet në anën e djathtë të lumit Shkumbin dhe vazhdon deri në trevat shqiptare në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni, Luginën e Preshevës. Tiparet e gegërishtes i gjejmë edhe në folmen e Mandricës në Bullgari. Dialekti toskë ka një shtrirje në të majtë të lumit Shkumbin, në të gjithë Çamërinë dhe arrin deri në gjirin e Artës dhe Prevezës. Më afër me këtë dialekt është edhe e folmja e arbëreshëve të Italisë. Kujtojmë, se prirja individualiste e artikulimit gjuhësor ka bërë që dialektet të ndahen në nëndialekte, nëndialektet në grupe të folmesh, këto të fundit në të folme krahinore. Ndarja vazhdon deri në të folmet individuale të individëve (idiolektet). Gegërishtja ndahet në dy nëndialekte: *gegërishtja veriore dhe jugore*. Si kufi ndarës mes tyre është

lumi i Matit. Toskërishtja ndahet në dy nëndialektet: *toskërishtja jugore dhe veriore*. Si kufi ndarës mes tyre shërben lumi i Vjosës (Gjinari, 1975: 44; Gjinari, Shkurtaç, 2003: 160 – 161). Nëndialektet e gegërishtes ndahen në grupe të folmesh. Objekti i studimit na kufizon në parashtrimin e plotë të ndarjeve të nëndialekteve në grupe të folmesh, ndaj do të parashtrojmë vetëm ndarjen në grupe të folmesh të nëndialektit të veriut në gegërishte. Nëndialekti i gegërishtes veriore ndahet në dy grupe të mëdha si: të folmet e gegërishtes verilindore dhe veriperendimore. Kufi ndarës mes tyre kanë Thethin dhe në jug lumin e Shalës. E folmja e Lumës ka qenë objekt studimi për shumë studiues të ndryshëm, ndaj mendimet për pozicionimin e saj në dialektin e Veriut dhe nëndialektin e tij kanë qenë të ndryshme. Lamberci, që më 1943, në përpjekjet e tij për klasifikimin e të folmeve të Gegërisë, të cilat i ndan në gegërishten *verilindore, perëndimore, të mesme, jugore dhe veriore*, në këtë të fundit përfshin edhe Lumën, së bashku me të edhe të folmen e Mirditës, Malziut, Hasin etj. Këtë ndarje Lamberci e paraqet edhe në vitin 1959 (Hoxha, 2007: 36).

Të folmen e Lumës B. Beci e shikon në pjesën e gegërishtes së mesme, duke përfshirë të folmen e poshtë Drinit, Malësisë së Tiranës, Martaneshit. Në këtë ndarje, B. Beci përfshin edhe të folmet që fillojnë që nga bregu i detit në perëndim dhe në lindje deri në Maqedoni. Beci, B. (1970) *Mbi grupin veriperëndimor në gegërishten veriore*, Studime Filologjike, Nr. 2, f. 134.

Xh. Gosturani nuk është shprehur qartë mbi vendin e të folmes së Lumës në grupin e të folmeve të gegërishtes. Ai e veçon të folmen e Lumës nga grupi i gegërishtes verilindore. Në këtë mënyrë, ai lë të nënkuptuar se e folmja e Lumës i përket gegërishtes qendrore. Gosturani, G. (1983) *Veçori gjuhësorë të gegërishtes verilindore*, Studime Filologjike, Nr. 4, f. 57 – 58

Jorgji Gjinari të folmen e Lumës e shikon pjesë të gegërishtes verilindore si grup i nëndialektit verior të gegërishtes. Gjinari, J. (1966) *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, Studime Filologjike, Nr. 4, f. 109 – 110.

Me tej, Gjinari shprehet se e folmja e Lumës është bartëse e disa nga karakteristikave të gegërishtes qendrore. Edhe vonë sipas J.Gjinarit dhe Gj. Shkurtaç e folmaj e Lumës është pjesë e të folmes së gegërishtes verilindore (Gjinari, Shkurtaç, 2003: 160).

Sipas Shefqet Hoxhës, e folmja e Lumës nisur nga dy dukuri gjuhësorë të kësaj të folmeje si zhvillimi i gupeve *kl* dhe *gl*, mënyra e shquarësisë së emrave mashkullorë me *k*, *g*, duhet të përfshihet në grupin verilindor të gegërishtes, por ajo është bartëse edhe të tipareve të gegërishtes qendrore (diftongimi i *i - së* në *ë i (ë j)*, *oi (oj)*, *ai (aj)*; zh buzorëzimi i *y - së* në *i*; qiellzorëzimi i *g* në *gj*; qiellzorëzimi i grupit *dj* në *gj* dhe i grupit *tj* në *q* ose velarizimi në *k*) (Hoxha 2007:329-330).

A. Desnickaja në punimin e saj “*Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*” mendon se e folmja e Lumës ndahet në dy grupe: *të tipit verilindor gegë* (ku dallohen trajtat e shquarësisë së emrave mashkullorë me *k* dhe *g* me mbare të *i*) dhe të *tipi të mesëm gegë*, i cili sipas saj përcakton edhe tiparin e përgjithshëm të së folmes së Lumës, (si tipare dalluese paraqet diftongimin e zanores *i* të theksuar në *ëj, oj, aj, ej* si dhe zh buzorëzimi e *y-së* në *i*). Kjo veçori fonetike e të folmes së Lumës nuk mund të merret si tipar determinues të përkatësisë në grupimin e të folmeve. I – ja e theksuar në të folmen e Lumës nuk del e diftonguar në të gjitha trajtat e paraqitura nga

Desnickaja dhe që shfaqen në gegërishten qendrore. Po ashtu zhbuzorëzimi i *y - së* në /i/ nuk është tipar përgjithësues në të gjithë të folmen e Lumës. Nga ana tjetër, janë shumë veçori të tjera që bëjnë dukshëm dallimin e të folmes së Lumës nga gegërishtja qendrore.

Nisur nga disa tipare kryesore dalluese fonetike dhe morfologjike të evidentuara nga shumë studiues, e folmja e Lumës i përket gegërishtes verilindore, por është bartëse edhe të disa karakteristikave të gegërishtes qendrore.

Cilët janë tiparet e gegërishtes verilindore që mbart e folmja e Lumës?

Ashtu si në gegërishten verilindore edhe në të folmen e Lumës, diftongjet *ae, oe* kanë dhënë respektivisht: /a:/, /o:/ (*tha*: < *thae*, *vo* < *voe*). Diftongu *oe*, jo në të gjitha rastet ka dhënë /o:/ në të folmen e Lumës. Grupet *kl* dhe *gl*, edhe në të folmen e Lumës janë reduktuar në elementët e parë *k e g*, kjo duket në fjalët: *klumsht* > *kumsht*, *gluni* > *guni* > *gjuni*.

Thjeshtimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, shq, ng*, në *m, n, sh, g*.

Dhe për nga tiparet morfologjike që ka si: shquarsia e emrave në *k,g*, me mbaresën *i*. si dhe prania e emrave ambigjen etj.

Në të folmen e Lumës, e pakryera formohet nga temat e pjesores me mbaresat - *shna* (- *jshna*): *punoj-sha, punojshna, lajsha - lajshna* për vetën e parë njëjës, edhe *me - ke* (- *jke*): *ardhke, vrajke, shkojke*, për vetën e tretë njëjës.

Cilët janë tiparet e gegërishtes qendrore që mbart e folmja e Lumës?

Diftongimi i *i - së* në *ë i* (*ë j*), *oi* (*oj*), *ai* (*aj*); monoftongimi i diftongut *ie* në *e*. Zhbuzorëzimi i *y - së* në *i*. Qiellëzorëzimi i *g* në *gj*. Ky tipar fonetik nuk mund të merret si tipar kryesor dallues i gegërishtes qendrore, pasi në të shumtën e rasteve në këtë të grupim, *g - ja* del e plotë pavarësisht nga pozicioni. Beci, B. (1972) *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime Filologjike, Nr. 4, f. 92. Qiellëzorëzimi i grupit *dj* në *gj* dhe i grupit *tj* në *q* ose velarizimi në *k*.

Tiparet fonetike të së folmes së Lumës

Tiparet fonetike të të folmes së Lumës do të parashtrihen duke filluar nga sistemi i zanoreve, sistemi i bashkëtingëlloreve, dukuri të ndryshme të fonetike, por me një fokusim të veçantë të dukurive dalluese të kësaj të folmeje.

Sistemi zanor i të folmes së Lumës

E folmja e Rrafshës së Lumës Ka një sistem zanor prej 22 fonemash, të cilat dallohen ndërmjet kundërvënies me vlerë fonologjike që ka shkalla e gjatësisë në dy skajet e saj, hundorësia, ngritja dhe buzorëzimi.

Sistemi zanor i të folmes së Lumës është si më poshtë:

/ a:/, /a/; /â:/, /â/ // /e:/, /e/; /ê:/, /ê:/; /ɛ:/, /ɛ:/ // /ë:/, /ë:/ // /o:/, /o:/ // /u:/, /u:/; /û:/, /û:/ // /i:/, /i:/; /î:/, /î:/ (Hoxha, 2007: 45).

Gjatësia e zanoreve

Zanore të gjata

Prania e zanoreve të gjata është një nga tiparet dalluese mes gegërishtes dhe toskërishtes, por jo një tipar qënsor në dallimin mes tyre, kështu do të shprehej A. Densickaja. Në përgjithësi, në

dialektin geg, gjatësia e zanoreve merr vlerë fonologjike pasi krijon disa çifte minimale të fjalëve si: *măz* – *ma:z* (*mëz* – *ajkë*), *çăj* – *ça:j* (*çaj pije* e *nxehtë* – *çaj drutë*), *kös* – *ko:s'* (*kosi* – *kosa*), *shtăt* – *shta:t'* (*trup* – *shtatë*). Hamiti, A. (2007) *Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike*, AKTET E TAKIMIT VEJTOR ISHA, f. 85

Në të folmen e Lumës vlera fonologjike e zanoreve të gjatë ekziston, por ka ardhur duke u zbehur. Zanoret e gjata i gjejmë në rrokje fundore të hapura, në rrokje të mbyllura pas rënies së *ë-së*, para disa bashkëtingëlloreve. Zanoret e gjata kur janë pas rënies së *ë-së* të patheksuar kanë një shpjegim pak a shumë me atë që quhet “dukuria e kompesimit sonor”. Rënia e *ë-së* ka bërë të mundur që zanorja paraprirëse të zgjatet për të pasur një artikulum më të lehtë dhe dallues.

Janë të gjata në pozicion fundor të hapur një shumicë zanoresh të theksuara në fjalë të tilla si: *hato*: (*hata-ja*), *ko*: (*kau*), *kalo*: (*kala*), *ko*: (*ai ka*), *kapërce*:, *ble*:, *dre*:, *kacadre*:, *the*: (*theje*), *ve*:, etj.

Zanoret e gjata të rrokjeve të hapura e ruajnë gjatësinë edhe kur kalojnë në rrokje të mbyllura si: *hato:ja*, *ka:vi*, *kalo:ja*, *vlllo*: - *vlla:zën*, *bzo*: - *bzo:m*, *fli*: - *fli:s*, *bri*: - *bri:nat*.

Zanoret e shkurtra

Në të folmen e Lumës paraqiten zanoret e shkurtra të theksuara gojore dhe hundore në fjali njërrrokëshe ose shumërrrokëshe që mbyllen nga një bashkëtingëllore, pas së cilës nuk ka pasur *ë*.

bik, *brac*, *cinkth*, *çep*, *daçek*, *direk*, *fturk*, *hajat*, *jelek*, *leprush*, *rud*, *koponec*, *rrah*, *tugj*, *thes*, *karaman*, *zogj*, *zagj*, *poll*, etj.

Paraqitet e shkurtër *i-ja* e theksuar gojore a hundore në pozicionin fundor në një gup emrash të njerëzve me origjinë turko-arabe. *Ali*, *Avni*, *Dali*, *Emri*, *Fasli*, *Fari*, *Gani*, *Haxhi*, *Hisni*, *Lutfi*, *Sabri*, *Shukri*.

Në këto emra, në trajtën e shquar njëjës, *i-ja* fiton në gjatësinë e saj duke u bërë e mesme si: *Avnia*, *Alia*, *Emria*, *Dalia*; ndërsa në rasat e zhdrejta *i-ja* fiton akoma më shumë në gjatësi duke u bërë një zanore e gjatë, *Avni:së*, *Ali:së*, *Dali:së*, *Emri:së* etj.

Zanoret e mesme

Zanoret e mesme janë të pranishme në të folmen e Lumës, të cilët janë formuar përmes dy rrugëve. Së pari duke u shkurtuar zanoret e gjata dhe së dyti duke u zgjatur zanoret e shkurtra, kjo dukuri mund të realizohet gjatë fleksionit të emrave.

Zanoret e shkurtra tek emrat gjatë fleksionit zakonisht zgjaten si në rastet: *bilizik* – *bilizi*: *ki*, *cëik* – *cëi*: *ki*, *farash* – *fara:shi*, *grefs* – *gre:fsi*, *kakruk* – *kakru*: *ki*

Ka edhe rastet kur zanoret e gjata gjatë fleksionit kalojnë në të mesme:

Buno:r – *bunori*, *hamo:r* – *hamori*, *kano:r* – *kanori*, *magjo:r* – *magjori*, *zagjo:r* – *zagjori* etj.

Hundorësia

Nazaliteti është një tipar fonetik i gjithgjendshëm në dialektin gegë dhe një nga tiparet dalluese me toskërishten. Nazaliteti i zanoreve, për Desnickajën, është një nga tiparet themelore dalluese mes dy dialekteve, Paçarizi, R. (2008) *Gjuha shqipe*, Thesis Kosova, Nr. 1, f. 102, ndërsa për M.

Totonin ky tipar është dallues, por jo ndër tiparet kryesore, sepse nazaliteti i zanoreve është i gjendshëm edhe në skajin më jugor të toskërishtes, pikërisht në fshatin Borsh. Totoni, M. (1964) *E folmja e bregdetit të poshtëm*, Studime Filologjike, Nr. 1, f. 136

Hundorësia është një tipar i rëndësishëm në të folmen e Lumës. Pavarësisht diskutimeve mbi vlerën fonologjike të zanoreve nazale në dialektin gegë, Hamiti, A. (2007) *Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike*, AKTET E TAKIMIT VEJTOR ISHA, f.85, në të folmen e Lumës kjo vlerë është ruajtur si e tillë (Hoxha, 2007: 83): *kâma* (kamba) dhe *kama* (shpatë), *âsht'* (është) dhe *asht* (ashti), *zihem* (ziej) dhe *zîhem* (zë, kap), *shkam* (stol druri) – *shkâm* (shkëmb), *kûj* (një hu në të cilin lidhen kafshët në vath) – *kuj* (kujt, si përemër pyetës, kujt me i thânë?), *thâ:n* (thanë) – *tha:n* (ata thanë).

Në Rrafshin e Lumës si zanore hundore paraqiten *â, ê, î, û*, ndërsa *o-ja* paraqitet si e tillë në disa raste, kjo në varësi të pozicionit që mbart, përkundër gjashtë zanoreve (*â, ê, î, û, ô, ý*) (Hoxha, 2007: 85), hundore të gegërishtes në përgjithësi. Ndërsa zanorja *y* nuk ka një tipar të tillë, në këtë të folme, për faktin se zhbuzorëzohet. **Ë-ja** nuk del në trajtën e një zanoreje hundore.

Artikulimi i zanoreve bazë në të folmen e Lumës

Në të folmen e Lumës, jo në të gjitha rastet, zanoret artikulohen në trajtën e tyre të plotë:

Zanorja **a** nuk artikulohet e plotë në trajtformat gramatikore të disa fjalëve. Ajo artikulohet si **uo** në fjalën *kuol* < *kal*. Në disa fjalë ajo del si **ëi** (**ëj**) në fjalën *strëjca* < *strajca*.

Zanorja **e** del e plotë në artikulim.

Zanorja **ë** e theksuar dhe e patheksuar. Pra siç shihet në të folmen e Lumës zanorja **ë** është një zanore shumë “pak e pranishme”, kjo duket edhe në artikulimet e fjalëve të tilla si: *t', i fort', kjer', më:jr*. **Ë-ja** fundore e patheksuar nuk shqiptohet edhe në emrat e gjinisë femërore, në nyjen e lidhore etj. Duhet theksuar se **ë-ja** e patheksuar ka rënë në çdo pozicion fundor të hapur si: *arush', klllo:s', merk'* (njerjë), po ashtu edhe në pozicion nistor si në fjalët: *knej* < *kënej* < *këndeje*, *kshu* – *kështu*. **Ë-ja** e patheksuar në trup të fjalës theksohet si në fjalët: *dimën, dhëlpën, votër, hutër*. Ajo është e pranishme në disa shprehje dhe fjalë onomatope si: *me t'bô gjith' ditën dërr –dërr, fturoi zogji fërr; bë:rret, kë:rr* (em), po ashtu ajo haset edhe në disa fjalë të huazuara ose të ndërhuara me elemente të huaja si: *budallaëk, hamallëk, baballëk, boshllëk* etj. (Hoxha, 2007: 49 -50). **Ë-ja** shpeshherë tek numërori **një** del si **i** dhe **nj-ja** del si **n** “I kshin qit **ni** kajk gjalit të Avllahit (Abdullahit)”.

Zanorja **i** del në disa trajta të diftonguara si: **ëi** (**ëj**) (*vëjn*<*vijnë*, *farefëjs* < *farefis*, *thëj* < *thi*), **oj** (*shoj* < *shi*, *troj* < *tri*, *rroj* < *rri*), **ai** (**aj**) (*taj* < *ti*). Ndërsa, sipas Sh. Hoxhës *i-ja* e theksuar ka dhënë si variante kryesore diftongjesh **ëi** (**ëj**) dhe **oi** (**oj**) (Hoxha, 2007: 329).

Zanorja **o** në disa fjalë del e diftonguar në trajtën **ëi** (**ëj**) si në fjalën *shkëjn* < *shkojnë*. Në disa raste po në të njëjtën fjalë (në disa zona të ndryshme) ajo del si **uo** *shkuojn*<*shkojnë*, *kaluojn*< *kalojnë*.

Zanorja **u** jo në të gjitha rastet artikulohet e plotë ajo në disa raste del e diftonguar në **ou** si në trajtën e shquar të disa emrave si: *nous – ja, es* < *nuse*, *couc – a, es* < *cucë*, *shtoun – a, ën* < *shtunën*. Në trajtën e pashquar **o-ja** del e padiftonguar dhe artikulohet si e plotë. Në disa raste të tjera kjo zanore del edhe në trajtën diftongore **ëi** (**ëj**) si te fjala (*fëjt* < *fut*).

Zanorja **y**, si e theksuar ashtu edhe patheksuar artikullohet e plotë në zonat ku nuk pëson zhbuzorëzimin, ndërsa në zonat ku ajo zhbuzorëzohet del në trajtën e **i – së**.

Grupet e zanoreve dhe diftongjet në të folmen e Lumës

Në të folmen e Lumës ekzistojnë disa togje zanoresh dhe diftongje që kanë një qëndrueshmëri në shfaqjen e tyre në pozicione të ndryshme në fjalë.

Grupet zanore: ue, ie, ae dhe oe

Në të folmen e Rrafshës së Lumës, togu zanor **ue** ka një shfaqje në pozicion fundor të hapur ose të mbyllur. Në artikulin e plotë të tij rrethimi fonetik ka një ndikim të madh.

Togu **ue**, në pozicion fundor të hapur ka prirje për të qëndruar si tillë si në fjalët: *ishin vllaznue, kishin ngeç n' prrue, as nuk i kish tregue, ish afrue shoum etj.* Nuk mungojnë edhe rastet kur në pozicion fundor monoftongohet në **u**. Duke kaluar nga një e folme fshati në një tjetër togu **ue**, shfaqet edhe si i plotë, por edhe i monoftonguar në të njëjta fjalë: *nuk u çue për t' përshëndet mi(y)safirët, u çu dhe iku; iku duke vrapue, për t' vrapu nuk dojke?!*

Në mes të fjalës, në përgjithësi togu **ue** monoftongohet në **u**: *na kallzu:n, e lshu:n pa i tha:n gjô.* Grupi **ue** ka një tendencë monoftongimi te brezi i ri, ndërsa brezi i vjetër në moshën 70 – 90 vjeç ka një tendencë të ruajtjes edhe në mes të fjalës. Këtë konstatim e ka vënë re edhe Sh. Hoxha (Hoxha, 2007: 156).

Në të folmen e Lumës, grupi **ie** herë del si grup zanoresh herë del si diftong. Si grup zanor ai del në pozicionin fundor të hapur si në fjalët: *bie, zie, përzie etj.*

Në pozicionin e mbyllur, grupi **ie** është monoftonguar në **i**, por edhe në **e**: *di:ll <diell, di:llën (dielën) erdh gjali, n' kup t' çells u dëgju (ue).* Nuk mungojnë rastet kur monoftongimi në **i** të ketë dhënë edhe diftongun **ëi (ëj)**: *miell > mi:ll > mëjlli, miel –e > mil – e > mëjl – e, ndien > nien > në:jn.*

Në të folmen e Lumës, grupet **ae** dhe **oe** nuk kanë ndjekur të njëjtën rrugë të zhvillimit, kjo është arsyeja që në këtë të folme kemi katër zona izoglosash të dallueshme të zhvillimit të tyre (Hoxha, 2007: 163).

Grupi **ae** është thjeshtëzuar në një **/e:/** të gjatë si në fjalët: *dhae > dhe:, pae > pe:, rae > re: etj.*

Grupi **oe** shfaqet si i tillë në fjalët *voe, droe*, por ai është shndërruar në **/o:/** në fjalët: *vëne ro: < vëne roe, kish pas rân' vo:s < voes.* Në disa raste grupi **oe** shfaqet i monoftonguar në **/o:/** edhe në fjalën *ndroe > droe > dro:*. Ky grup në të folmen e Arrnit është ruajtur, pothuaj në të gjitha shfaqjet e tij. Hoxha, Sh. (2005) *E folmja e Arrnit (II)*, Dialektologjia shqiptare VII, AKSH, IGJL, f. 482 Në të folmen e Lumës, kemi krijimin e një grupi të ri, i formuar nga bashkimi i **o – së** së temës, kjo në disa folje në urdhërore, numër njëjës, me trajtën e shkurtër të përemrit vetor si në rastet: *punoe, fërkoë, shtoe, paloe* etj. Sipas Sh. Hoxhës edhe në këto raste kemi thjeshtëzimin në **/e:/**. Sot nga vëzhgimet e bëra ky grup qëndron si i tillë në brezin e vjetër, ndërsa në brezin e ri del më shumë në trajtën e një **o – je** të gjatë si: *palo:, fërko:, shto:, puno:*. Zhvillimi i këtij grupi në këtë formë mund të shikohet si një tjetër prirje normativizuese drejt standardit.

Diftongu ie

Diftongu **ie (je)** në të folmen e Lumës është thjeshtëzuar **e** si: *me:shtër <mjeshtër, pe:ll' <pjellë, bere <bjerë, dhët' <dhjetë, vet <vjet.* Kjo dukuri fonetike është shumë e pranishme edhe në gegërishten

qendrore dhe më pak në atë verilindore. Beci, B. (1964) *E folmja e Reç - e Dardhës së Dibrës*, Studime Filologjike, Nr.4, f. 144

Dukuria e rotacizmit në të folmen e Lumës

Rotacizmi, si një dukuri dalluese mes dy dialekteve, në të folmen e Lumës nuk ka ndodhur.

N -ja ndërzanore në këtë të folme është mbajtur si e tillë në shumë fjalë, që në dialektin e jugut ajo është kthyer në r. Le të shohim disa fjalë: *dimni* (trajta e shquar, ndërsa e pashquara është *dimën*), *dashni* është variant i fjalës *dashuni*; *bana, lakna, hina (hyna), zuni* (pjesora e foljes *zë*), *druni, huni, dhelpna, brina -t <bri (brirët)* etj. Në të folmen e Lumës, në ditët e sotme vihet re një tendencë të realizmit të kësaj dukurie si te fjalët: *dimër, dhepër, lakër, dashuri* etj. Kjo tendencë mund të shpjegohet si një prirje drejt normativizimit.

Zhbuzorëzimi i y-së në i

Në përgjithësi, në të folmen e Lumës zanorja **y** nuk del si buzore, por në formën e **i -së** duke u zhbuzorëzuar. Kjo dukuri është e pranishme si në Rrafshën e Lumës, si në të folmen e fshatit të Novosejës. Le të shohim disa fjalë që karakterizojnë këtë dukuri fonetike në këtë të folme: *Hina (Hyna), Gjigim (Gjygim), sini (syni), miti (mbyti), timi, pill (pyll), ill (yll), dill (dyll), fiell (fyell)* etj. Në disa fshatra artikulumit i **y -së** diftongohet në **oi (oj)** si në rastin *so:j - si -sy. Si nuk ia pat qit so:jt gjalit.*

Këtë dukuri, Sh. Hoxha e shikon të pranishme edhe në atë që ai e quan Dollovishtë, por shtrirja gjeografike e kësaj zone nuk i përket Lumës. Nga ana tjetër, kjo zonë nuk është pjesë e Lumës as gjuhësisht, as kulturalisht kjo zonë është pjesë organike e Gorës.

Edhe në të folmen e Lumës, ashtu si në të gjithë gegërishten, është ruajtur ligji i rregullimit mekanik të theksit në fjalët e huazuar nga turqishtja në fjalë të tilla si: *tenxhére - tenxheré, penxhére - penxheré, tenéqe - teneqé, shíshe - shishé, etj.* Sipas J. Gjinarit ky tipar fonetik është tipar dallues mes gegërishtes dhe toskërishtes edhe pse në këtë të fundit kemi disa fjalë të huazuar që dalin me theks paroksiton. Paçarizi, R. (2008) *Gjuha shqipe*, Thesis Kosova Nr. 1, f 103

Sistemi bashkëtingëllor i të folmes së Lumës

E folmja e Lumës ka një sistem bashkëtingëlloresh prej 30 fonemash (Hoxha, 2007:197). Fonema **ŋ** është fonema e 30 - të në të folmen e Lumës. Ajo del nga asimilimi i grupit **ng** dhe artikullohet si një grykore. Sipas Sh. Hoxhës ajo mund të identifikohet nëpërmjet kundërvënieve fonemore, pothuaj me të gjithë bashkëtingëlloret e tjera (*ŋe - re, ŋe - rre, ma:ŋ*) (Hoxha, 2007: 256 - 267). Sipas vështrimeve tona, kjo fonemë ka një tendencë të zbehjes dhe të zëvendësimit me fonemat bashkëtingëllore të shqipes standarde, kjo sidomos tek brezi i ri. Pavarësisht trajtformave të artikulumit dhe zhvillimit të grupeve të ndryshme të bashkëtingëlloreve. Interes të veçantë paraqesin disa grupe bashkëtingëlloresh si: *mb, ng, nd, tj, sht* si dhe bashkëtingëlloret *d, g, l*.

Grupet e bashkëtingëlloreve mb, ng, nd, tj, sht, pj, nx dhe dj

Grupet e bashkëtingëlloreve, ashtu si në të gjithë dialektin e gegërishte, **mb, ng, nd** konsonatizohen në **m, g, d**, si në rastet: *kâma (kamba), kënimi (Këndimi i librave)*. Ndërsa në fjalën

kanga, gjendet një formë tjetër që është *kajka*, ku mendimi ynë është se kjo formë mund të jetë e hershme e fjalës *kënga*. Grupi *nd* ka mbetur *n* si në fjalët: *ndonjë –no(n)jë, muni –mundi (mundi im), katun –katund, knej –kënej –këndej* etj. Nuk mungojnë rastet kur grupi *nd* të thjeshtësohet në *d* si në fjalën: *daje – ndaje (ndaje në dy pjesë)*.

Grupi *ng* thjeshtohet në *g* në fjalë si: *gul – ngul, gihem – ngihem (ngopem), gat – ngat (afër)*.

Grupi *tj* nuk artikullohet si i tillë në fjalën tjetër, por ai del si një *k* jo velare, por një *k* sa më afër qiellzores si: *qetër <ketër< tjetër*, nuk mungojnë rastet edhe kur ajo del thjesht si një qiellzore si në fjalë n: *qe:rr < tjerrë (me qe:rr < me tjerrë)*.

Grupi *sht* thjeshtëzohet në *sh* si në fjalën: *shpoj, shpëj < shtëpi, e dashme < e dashtme < i dashtun*, por jo në të gjitha rastet ky grup del i thjeshtëzuar, pasi ai në shumë fjalë del i plotë si: *shtart, shtëj (shtie), shtroj* etj.

Grupi *pj* thjeshtëzohet në *p* në disa fjalë të tilla si: *pjek – pek*, ndërsa në disa fjalë të tjera del i realizua i plotë si: *pjerrët, pjeshkë*

Grupi *nx* thjeshtëzohet në *x* si në fjalët: *nxehët – xehet, nxihet – xihet*, ndërsa në disa fjalë të tjera del si i plotë: *nxerre – nxirre*.

Grupi *dj* del në trajtën e një qiellzoreje të zëshme *gj*, kjo trajtë e të folmes së fshatit Bicaç si në fjalë t: *djath >gjath, djalë >gjäl'*.

Bashkëtingëlloret g, gj, dhe l

Në të folmen e Lumës bashkëtingëlloret *g, gj* dhe *l*, jo në të gjitha rastet artikulohe si të tilla.

Fonema grykore *g* qiellzorizohet në *gj* si në fjalët: *gjrumbull –grumbull, gjur –gur, lugja –luga, lagj –lag, gjrik' – grykë, etj.*, shfaqet si tipar i gegërishtes qendrore, Beci, B. (1986) *Të folmet e gegërishtes qendrore*, Dialektologjia V, f.10, po ashtu si tipar i këtij nëndialekti është edhe shndërrimi i grupit *tj* në *q*.

Në disa të folme të disa fshatrave të Lumës qiellzorja *gj* del si grykore *g* si në fjalë të tilla: *i gat' – i gjatë, gat' – gjatë*, shumë rrallë del edhe fjalë *guh' – gjuhë*. Në këtë të folme vihet re edhe një artikulum i **ll-së** në vend të **l** si në fjalët: *secalli – secili, dill –diel*.

Grupit vo përkundrejt grupit va në standard

Kjo e folme është bartëse e grupit **vo** si në të gjithë dialektin gegë. Në të folmen e Lumës **o -ja** në këtë grup deri diku paraqitet si e gjate, ndryshe nga te folmet e tjera ne dialektin gegë ku paraqitet e mesme si tek fjalet: *vo:j –voj- vaj, vo:jti – vojti – vajti*, tek fjala *votër* ajo paraqitet e mesme, ndersa tek fjala i *vorfën* grupi **vo** nuk paraqitet si i tillë, por si *va*, i *varfën*.

Tiparet morfologjike të të folmes së Lumës

Sistemi emëror

Gjinia në të folmen e Lumës

Në të folmen e Lumës sistemi emëror paraqitet në tre gjini, ashtu si në të gjithë gjuhën shqipe. Në sistemin emëror të kësaj të folmeje vëmë re një denduri të përdorimit të emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore, duke krijuar përshtypjen se emrat e gjinisë asnjane nuk ekzistojnë.

Emra të gjinisë asnjans, si në gjuhën shqipe standarde, janë emra prejfoljorë të tipit: *t' ecunit, t' folunit, t'vatunit*.

Gjinia, në këtë të folme, është fare mirë e përcaktuar nga formantet që e shprehin në trajtat përfaqësuese të emrit dhe kemi: *shkam-i (stol druri), fte:j -ni (dybeku), saç-i; bucel -a, hastër -a (shtroje për të fjetur), shilte -ja; t' ecunit, t' folunit, t' rit (të rinjtë)*. Disa emra të gjinisë mashkullore, në shqipen standarde, në të folmen e Lumës dalin si emra të gjinisë femërore: *shek - a (bodrumi), cerk- a (qilim)*. Edhe në të folmen e Lumës kemi praninë e emrave ambigjen të tillë si *katun i nalt' - katune t' nalta*.

Lakimi në sistemin emëror të të folmes së Lumës

Krahasuar me shqipen standarde, në të folmen e Lumës kemi një sistem emëror prej tri lakimesh. Lakimi i parë shfaqet i plotë ashtu siç shfaqet në gjuhën standarde me mbaresat përkatëse si: *gjal - i, kal - i, drun - i, mal - mali etj*.

Lakimi i dytë i shqipes standarde, në të folmen e Lumës nuk ekziston. Trajta përfaqësuese e emrave të këtij lakimi në këtë të folme del si trajta përfaqësues e emrave të lakmit të parë, si në rastet: *lek -i uk-i, polik -i, lug -i, breg -i, snëjk -i, kakruk-i*.

Në këtë të folme shumë emra njerëzish të lakimit të dytë të standardit i përkasin lakimit të tretë: *Avni (Avni -a - ja dhe jo Avni -u, Remzi - a - ja dhe Remziu)*, Ndërsa disa emra të tjerë marrin trajtat e lakimit të parë si: *Avdulla - Avdullai etj*.

Sipas A. Desnickajës, ky tipar dallues përbën një nga dallimet kryesore të gegërishtes verilindore, por nuk e shikon si të tillë në të folmen e Lumës.

Lakimi i tretë është tepër i dukshëm nga formantet që shprehin gjininë dhe lakimin, ndaj kemi: *brij -a, shek- a (vendi ku mbahen bulmetrar, bodrumi), tepso:j -a, maxhe -ja, kroçe -ja (enë me dorezë dhe kapak që shërben për të marrë ushqim në punë, nëpër ara)*.

Lakimi i tretë i kësaj të folmeje është korresponduesi i lakimit të katërt në gjuhën standarde. Ky lakim është reduktuar së tepërmi në sasinë e emrave që e përbëjnë, pasi vetë gjinia përcaktuese e tij është në reduktim të vazhdueshëm.

Formimi i shumësit në të folmen e Lumës

Shumësi i emrave formohet në disa mënyra, që në shumë raste janë tipare dalluese me të folmet tjera. Disa emra e formojnë shumësin vetëm me anë të mbaresave të shumësit, disa të tjerë e formojnë përmes ndërrimit të tingujve dhe mbaresave përkatëse. Ka emra që e formojnë shumësin pothuaj me një trajtë tjetër, kjo në formën e trajtës supletive.

Në të folmen e Lumës ashtu si në të gjithë gegërishten janë një grup emrash të gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe e formojnë shumësin vetëm me mbaresën **a** si : *ve:ll -a (t), ukij - a(t), plluc:k -a(t),shpa:ll -a(t), li:sk -a(t), karaman -a (t), grefs - a (t), argjat - a(t), koponec - a (t), gjisht - a (t), brin -a (t) etj*.

Emrat që e formojnë shumësin vetëm me mbaresën **t** të tillë si: *musllukçoj -t, lirek -t, kitap -t, kalo -t, daçek -t, luxh - luxht etj*.

Emrat që e formojnë shumësin me mbaresën **nat** të tillë si: *kacadre -nat, ksepadr -nat, bre -nat*.

Emrat që e formojnë shumësin vetëm me prapashtesën **e** të tillë si: *katun – katune, lugj – lugje etj.*
Emrat që e formojnë shumësin me ndrymë tingujsh (zanoret) dhe me mbaresën **t** ose **at**.

1. Përmes apofonisë, mbaresës **t** dhe **at**: *xhrabuj – xhrebujat, kajk – këjkët, gjal – gjemt, cap – cept.*
2. Përmes metafonisë dhe mbaresës **t** ose **at**: *bunor – bunart, kacô:j – kacë:jat.*
3. Përmes rënies së tingujve dhe shndërrimit të zanoreve: *mugji – mgjëjat, fto:j – ftëjt.*

Emrat që e formojnë shumësin me ndërrime tingujsh (bashkëtingëllore) dhe prapashtesën **t**

- Fturk –fturqt (qiellzorizimi i velars k + prapashtesa t)
- Koû – qijet (qiellzorizimi i velars k + shndërrimi i togut *uo* në *ëj* + prapashtesën -t)
- Kumë:jll – kumejt (qiellzorizimi i ll + shndërrimin e *ë –së* në *e* + prapashtesën -t)
- Drapën - drëpëjt një formë shumësi ndryshe nga të tjerat

Pra, siç shihet në të folmen e Lumës kemi një mori formash të realizmit të numrit shumë, duke shpalosur pasurinë e madhe formale. Në të folmen e Lumës kanë mbetur si rudimente edhe disa mbaresa të turqishtes që përdoren për të formuar shumësin e disa fjalëve të huazuara nga turqishtja si në rastin; *hasret – hasretxhit*. Për mendimin tonë formimi i shumësit është bërë përmes formaniti **t**.

Mbiemrat

E folmja e Lumës ka një sistem mbiemëror si në gjuhën standarde në kundërvënien mbiemër i nyjshëm dhe i panyeshëm: *gjal' përsëmbari, gjal i hijshëm.*

Ashtu si në gjithë gegërishten edhe në të folmen e Lumës në mbiemrat prejfoljor kemi reflektimin e gjinisë si: *i krehun, e krehme, i lam', e lame, i dashtun, e dashme, i vujtun, e vujtme, i vram, e varme, i dam, e dame, e fërgume etj.* Këtë tipar morfologjik, J. Gjinari e shikon si një ndër tiparet dalluese mes dy dialekteve dhe që haset në të gjithë dialektin e Veriut. Paçarizi, R. (2008) *Gjuha shqipe*, Thesis Kosova Nr. 1, f.104

Në të folmen e Lumës ndeshën edhe mbiemrat me prapashtesën *shëm (shm –e)*: *i paknushëm, e paknushme, i knaqshëm, e knaqshme, i fajshëm, e fajshme, i thishëm (shkami noiherë asht i thishëm), i pnushëm, e punushme (dhevi a i pnushëm deri sa a i lagt), i veshëm (sa her del i veshëm si kallamoq), i kalushëm (kët' dimën lumi a i pakalushëm).*

Përemrat

Në të folmen e Lumës përemrat dëftorë: *ky, kjo, këto, ai, ajo, ato* kur duan të individualizojnë një send, një njeri dalin në trajtat: **em**: *qeki, qekjo, qekto, qai, qajo, qato*; **gj**: *qektij, qekjo, qetëjne, qatij, qasaj, qatëjne*; **kall**: *qikët, qat', qikto, qat'/qata, qat/qato, qato*; **rrj**: *qëktëj, qisaj, qatëjne, qatëj, qasaoj, qasaj.*

Në këtë të folme si përemra e pacaktuar karakteristike mund të përmendim si: *secalli (secili), ca (disa), gjithsecalli (gjithsecili), asnjâ (asnjë), kurkush (askush) etj.*

Si në shumë të folme të tjera të veriut edhe këtu kemi përdorimin e përemrave pronorë vetvetorë: *e vet, të vet, i vet*. Në të folmen e Lumës hasen edhe përdormi i përemrave në shumë vetëm në gjiniën femërore si: *kta, kto, ata, ato*. Përdorimin e trajtave mashkullore të përemrave pronorë edhe për gjininë femërore si; *tanit, tannin* (Hoxha, 2007:32).

Realizmi i paskajores si tipar dallues i të folmes së Lumës

Në të folmja e Lumës, si në tërë dialektin geg, kemi praninë e paskajores *me punu*, ku grupi **ue** shndërrohet **u** si: *me punu, me këndu etj.*

Në këtë të folme paskajorja shpeshherë përdoret në vend të lidhore të kohës së tashme si: *Du me luftu (dua të luftoj), du me punu (dua të punoj), du me jetu (dua të jetoj)*. Në parashtrimin e togut të zanoreve *ue*, Sh. Hoxha paraqet disa raste ku grupi **ue** del si i tillë në relizmin e paskajores si në rastet: *a ni:s me shkue, po do me pushue etj.*, (Hoxha, 2007:154).

Format e mbipërbëra të së shkuarës

Edhe në të folmja e Lumës gjenden forma të mbipërbëra për kohën e shkuar të tipit "*ish pas kan*", "*kish pas ardh*". Kuptimi leksikor i këtyre formave ka të bëjë me artikulumin e një kohe tepër të largët. Kjo formë gjendet në strukturat klishe të përrallave, tregimeve dhe të folurës së përditshme.

Në të folmen e Lumës hasen trajtat foljore të foljeve ndihmëse *kena, jena*, në vend të trajtave *kemi dhe jemi*. Si në fajlitë: "*Kena pas ardh herët n'mëngjes*", "*Jena von' me shku n' xhamo:j me fal namazin*"

Në këtë të folme vihet re qartazi përdorimi më i dendur i pjesës mohuese *s'* në vend të pjesës *nuk*. Pjesëza mohuese *nuk* mund të thuhet se në një kohë të hershme nuk ka qenë e përdorur pothuajse fare. Kohët e fundit vihet re se pjesëza *nuk* po fiton një vend gjithnjë e më të madh në të folurën e Lumës përballë pjesëzës *s'*.

Pasuria leksikore dhe frazeologjike e së folmes së Lumës

Emërtimi i realitetit dhe krijimi i komunikimit në një zonë të caktuar ka bërë të mundur pasurimin, nga një brez në një brez tjetër, e leksikut, dallimin dhe veçimin nga të tjerët. Në këtë aspekt edhe e folmja e Lumës karakterizohet nga një pasur jo e vogël leksikore në shumë fusha të ndryshme të jetës. Pasuria leksikore, e të folmes së Lumën, në fusha të ndryshme është dëshmi e pasurisë gjuhësore, potencës zhvillimore të saj, lashtësisë dhe bashkëjetesës me gjuhë të tjera që e rrethojnë. Për këtë na dëshmojnë emërtime të ndryshme si emërtimet e **orendive shtëpiake**: *fter (tigan), maxhe (Vend ku mbahej buka dhe enët e kuzhinës), brij (enë druri në të cilën mbahej uji), shek (bodrum), ftoë:j (dybek), koftorr (sobë vetëm për ngrohje), tagor (mangall), Shtrungë (enë në të cilën milnin bagëtitë.), polik (enë me bisht, shërbente për të marrë ujin e ngrohtë nga kazani ku është ngrohur), cerk (qilim prej lesh dhije), kistër (çengel i vogël për të kapur petullat), shkam (stol druri), voz (enë druri që shërben për të mabjtur turshi).*

Në fjalët e mësipërme vihet re elementi tipik krahinor, ku tregohet fantazia e popullit të Lumës për të emërtuar realitetin në të cilin ka jetuar. Vihet re një sërë fjalësh me prejardhje onomatopeike si: *fter (tigan)* (sipas mendimit tonë kjo fjalë është imitimi i tingullit që prodhohet gjatë skuqjes); *tagor (mangall)*, çkjo fjalë është imitimi i tingullit që prodhohet gjatë lëvizjes së mangallit, pasi ai është një mjet i përbërë nga hekur i hollë (llamarinë), dhe prodhon një tingull karakteristik *tang, tang*]. *Shtrungë (enë në të cilën milnin bagëtitë)* fjalë e cila mund të ketë pësuar ndryshim kuptimor nga kuptimi i parë drejt kuptimit të dytë, por pa ndryshuar

fushën konceptore. Në interpretime të etimologjisë popullore kjo fjalë shikohet si me prejardhje onomatopeike; *sipas tingullit që lëshon qumështi në enën ku millet*. Në parashtrimin e prejardhjes së saj, Idriz Ajeti sjell një kuptim të evidentuar nga Nopcza si *vend ku millet bagëtia*. Edhe në parashtrimin e Nopcza – së shikohet një nuancë semantike të ngjashme me atë që emërton në Lumë. Pavarësisht kuptimeve që mbart dhe krijon, kjo fjalë është e burimit shqip, Ajeti, I (1972) *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptaro – sllave*, Studime Filologjike, Nr. 4, f. 88 – 89 dhe është e pranishme në gjithë fondin themelor të gjuhës shqipe.

Elementi autokton i emërimit dhe një pasuri jo e vogël paraqitet në **emërtimin e botës baritore**: *Vath (vendi ku rojn kafshët), kûj (një hu në të cilin lidhen kafshët në vath), gjasht (vedni ku i hidhet ushqimi bagëtisë), xhibre (asht shtresa që i asht lan kafshve për mos me mërdho:j), kërpesh (litari si lidhim kuolin), strëjca e taxhis' (thesi ku i hithet drithi (taxhia) kalit për të ngrënë), luxh (hambari ku hidhet drithi i bagëtisë), nërbarksja (rrëjp ose lëjdhse që man samrin e kuolit ose magjarit), palldërm (pjesë e samarit), fre (litari me të cilin ndalon kalin kur është duke vrapuar),lop-a, mushtjerr (viç femër një vjeçar), kûo (kau), dhent', shtërr (lopa shterp'), dhoj (dhia), kuol (kali), ftuj (dhija një vjeçare), cap (cjap një vjeçar), magjaor (gomari), Çuran (gjel deti)*

Një shumësi fjalësh tregojnë për interferencat kulturore të popujve mes tyre.

Interferencat leksikore me të shumta janë nga turqishtja dhe sllavishtja. Fjalë që tregojnë interferencën e leksikut të gjuhës turke në përditshmërinë e lumjanëve janë si: *Tepso:j, sofër, snjk (sënduku), shilte (dyshek i vogël), tokmak (mjet që shërben për të ngjeshur tokën, sidomos gropat e vreshtës).*

Afërsia e Lumës me vendet ku jetojnë komunitete sllave ka bërë që të ketë shumë fjalë me origjinë sllave të tilla si: *shporet (sobë që shërben edhe për të gatuar dhe pjekur bukë), saç , vorb'-a (ënë balte që përdoret ëpr të zier fasule), hastër (shtroje për të fjetur), kant', ose kroçe (ënë që shërbente për të mbajtur kosin ose dhalltin në arë kur ishin në punë), korit (mjet që shërben për të larë), porëjk' (një copë druri që shërbente për të larë rrobat në krua), postoçi (lëkurë dashi,që përdorej për t'u ulur), kopaç (lloj kazme, që ka vetëm një anë funksionale) kacë:j (vegël prej metali, shërben për të hequr hirin nga soba), teslic –a (sqepari), xhrabuj (grebujë), çuski (mjet prej hekuri që shërben për të thyer gurë të ndryshëm), xhibre (edhe pse ne te folmen e Lumës ka pësuar një lëvizje kuptimore nga pleh në shtrojë për të mos patur ftohtë kafshët).*

E folmja e Lumës mund të konsiderohet një univers potencial në pasurinë leksikore që mbart, një mundësi me tepër ku mund të gjemë fjalë të së folmes arkaike shqiptare. Përvoja dhe dituria e popullit të Lumës është e jashtëzakonshme në të gjitha fushat e jetës. Një përvojë e mbishtresëzuar sipas brezave, ku nuk mungojnë gjurmë që nga e kaluara e hershme deri në të sotmen.

Përfundime:

1. E folmja e Lumës, për nga tiparet dhe veçoritë e saj është një e folme që i përket gegërishtes verilindore, por që mbart edhe disa tipare të gegërishtes së mesme (qendrore).
2. Në të folmen e Lumës gjemë një sistem zanoresh prej 22 fonemash të ndara në: zanore të gjata, të shkurtra, të mesme, hundore dhe jo hundore. Gjatësia dhe hundërisa e zanoreve kanë vlerë fonologjike edhe pse vazhdojnë të pësojnë një zbehje të vazhdueshme.
4. Zanoret bazë të shqipes, në të folmen e Lumës, kanë reflekse të ndryshme, përjashtuar e - në {a >ou, ëi (ëj), a; ë > ë, ëi (ëj), i > i, ëi (ëj), oi (oj), ai (aj); o > ëi (ëj), uo; u > u, ou, o}. E -ja del si e tillë, pothuaj, në të gjitha pozicionet.
5. Zanorja /ë/ e patheksuar ka tendencë bjerjeje, por ajo haset në fjalët me prejardhje onomatopeike dhe të huazuara.
6. Në të folmen e Lumës kemi praninë e grupeve të zanoreve *ue, ie, ae, oe* me reflekset e tyre si: *ue > ue,u; ie > i,e, ëi (ëj); ae > e, ae; oe > o,oe*.
7. Sistemi bashkëtingëllor it ë folmes së Lumës është i përbërë nga 30 fonema. Fonema e 30 - të është rezultat i nyjetimit të grupit *ng > ŋ* dhe del në trajtën e një grykoreje. Interes paraqesin grupet e bashkëtingëlloreve: *mb, ng, nd, tj, sht, pj, nx dhe dj* si dhe bashkëtingëlloret *g, gj, dhe l* në artikulinim e tyre.
9. Në të folmen e Lumës kemi praninë e grupit **vo** si në të gjithë dialektin geg: *voj -voj- vaj, vo:jti -vojti -vajti*, ndërsa tek fjala *i vorfën* grupi **vo** nuk parqitet si i tillë, por si *va, i varfën*.
10. Gjinia e emrave në të folmen e Lumës paraqitet si në gjuhën standarde. Disa emra të gjinisë mashkullore në shqipe standarde, në të folmen e Lumës dalin të gjinisë femërore të tilla si: *shek - a (bodrumi), cerk- a (qilim)*.
11. E folmja e Lumës ka një sistem emëror prej tre lakimesh. Mungon lakimi i dytë, pasi emrat e këtij lakimi shfaqen si të lakimit të parë: *uk-i, mik-i etj*.
12. Në të folmen e Lumës vihet re se shumësi i emrave formohet në disa mënyra, që në shumë raste janë tipare dalluese me të folmet e tjera
13. Në të folmen e Lumës, si në tërë dialektin geg, kemi praninë e paskajores *me punu*.
14. E folmja e Lumës karakterizohet nga një pasuri leksikore, që dëshmon për imagjinatën krijuese të popullit të Lumës. Pasuria leksikore e kësaj krahine dëshmon edhe për interferencat leksikore të sllavëve dhe të gjuhës turke.

Bibliografia

- Ajeti, I. 1972. Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptaro - slave, *Studime Filologjike Nr.4*, Tiranë, f 88 - 89.
- Beci, B. 1972 E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës, *Studime Filologjike Nr. 4*, Tiranë, f. 92.
- Beci, B. 1970. Mbi grupin veriperndimor në gegërishten veriore, *Studime Filologjike Nr. 2*, Tiranë, f. 134.
- Beci, B. 1964. E folmja e Reç - e Dardhës së Dibrës, *Studime Filologjike Nr.4*, Tiranë, f. 144.
- Beci, B. 1968. *Të folmet e gegërishtes qendrore*, Dialektologjia V, Tiranë, f. 10.
- Dokle, N. 1999. *Kukësi vështrim enciklopedik*, Geer, Tiranë.

Gosturani, Xh. 1983. Veçori gjuhësore të gegërishtes verilindore, *Studime Filologjike Nr. 4*, Tiranë, f. 57 - 58.

Gjinari, J. 1975. *Dialektologjia Shqiptare*, Universiteti i Tiranës, Tiranë.

Gjinari, J. 1966. Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe, *Studime Filologjike Nr. 4*, Tiranë, f. 109 - 110.

Gjinari, J; Shkurtaç, Gj. 2003. *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë.

Hamiti, A. 2007. Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike, *Aktet e takimit vejtor isha*, Shkup, f. 85.

Hoxha, Sh. 1999. *Luma në gjysmën e parë të shek XIX*, Tiranë.

Hoxha, Sh. 2007. *E folmja e Rrafshës së Lumës (Fonetika)*, GERR, Tiranë.

Hoxha, Sh. 2005. E folmja e Arrnit (II), *Dialektologjia shqiptare VII*, AKSH, IGJL, Tiranë, f.482.

Paçarizi, R. 2008. Gjuha shqipe, *Thesis Kosova Nr. 1*, Prishtinë, f. 102 -104.

Totoni, M. 1964. E folmja e bregdetit të poshtëm, *Studime Filologjike Nr. 1*, Tiranë, f. 136.

Sako, Z, 1972. Rreth gjenezës së valles pyrike, *Studime Filologjike Nr.4*, Tiranë, f. 95 - 98.